

J E T A S H K E N C O R E

SESION SHKENCOR PËR NDER TË XX VJETORIT TË ÇLIRIMIT

Prej datës 2 deri 5 nëntor zhvilloi punimet sesioni shkencor për nder të XX vjetorit të çlirimit të atdheut, i organizuar nga Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, fakulteti i Histori-Filologjisë dhe Instituti i Folklorit. Në të mirrnin pjesë punonjës shkencorë të institucioneve të lartpërmendur, bashkëpunorë të jashtëm të tyre dhe të ftuar të tjerë. Merrte pjesë edhe Rektori i U.Sh.T. shoku Kahreman Ylli. Seanca e parë plenare u hap n'orën 8 të datës 2 nëntor.

Sesionin e deklaroi të hapur sh. Zihni Sako, drejtor i Institutit të Folklorit. Ai ia dha fjalën shokut *Androkli Kostallari* drejtor i Institutit të Historisë dhe të Gjuhësisë, i cili foli mbi temën "*Shkencat albanologjike në njëzetvjetorin e çlirimit*". Mbasi vuri në dukje përparimin e atdheut tonë gjatë këtyre 20 vjetëve, referonjësi tha se pjesa e pandarë e këtij përparimi dhe rezultat i udhëheqjes së drejtë të P.P. SH. janë edhe sukseset e arritura në kërkimet shkencore, midis të cilave dhe në ato albanologjike. Ai bëri historikun e institucioneve kërkimore albanologjike që nga krijimi i tyre në vitin 1947 e deri në ditët tona, kur numri i kuadrove shkencore është dhjetëfishuar. A. Kostallari foli mbi punën e përpjekjet e këtyre kuadrove për të nxjerrë në dritë të kaluarës e largët e të afërt të popullit tonë, traditat e tij kulturore e shpirtërore, pasuritë e gjuhës së bukur shqipe, shpirtin e thellë poetik të popullit tonë të pasqyruar në vepra të pavdekëshme në folklor, letërsi, art e arkitekturë.

Ndër hapat vendimtare që ka bërë albanologjia ai vuri në dukje:

1) Shkencat albanologjike shqiptare në mbështetje të metodologjisë marksiste-leniniste i kanë bërë një analizë të shëndoshë trashëgimit shkencor të së kaluarës, e kanë

përgjithësuar atë dhe kanë bërë hapa të mëtejshme.

2) Shkencat albanologjike kanë hyrë në rrugën e një zhvillimi të organizuar e të planifikuar.

3) Është krijuar një bashkëpunim i ngushtë midis fushave të ndryshme të kërkimeve historiko-filologjike.

4) Shkencat albanologjike janë bërë të pavarura.

5) Qendra e studimeve albanologjike është bërë Shqipëria.

Sh. Androkli Kostallari theksoi se megjithë kohën e shkurtër që ka kaluar që nga Konferenca e Parë Albanologjike, gjithësej 2 vjet, punonjësit shkencorë të albanologjisë kanë me se të paraqiten në këtë sesion shkencor.

Midis sukseseve më të rëndësishme të kohëve të fundit ai përmendi: zbulimet arkeologjike të Maliqit që provojnë vazhdimësinë kulturele nga shtresa e bakrit n'atë të bronxit; zbulimet e Krotinës — fragmente tullash me vula që mbajnë emrin Dimalitan (ΔΙΜΑΛΙΤΑΝ) emrin e qytetit të vjetër Hir Dimal — që japin mundësi në përcaktimin e vendit të këtij qyteti; zbulimet në Apolloni; përfundimin e *vëllimit të dytë të "Historisë së Shqipërisë"* që përfshin periudhën 1839-1944 — periudhën më të pasur dhe më të rëndësishme të historisë së vendit tonë; është në përfundim e sipër *vëllimi i tretë i Historisë së Letërsisë shqipe* në dy pjesë (pjesa e parë "*Letërsia e viteve 1912-1944*" dhe pjesa e dytë "*Letërsia e realizmit socialist*"); kanë hyrë në një fazë të re punimet për dy veprat e mëdha kolektive në fushën e gjuhësisë: *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe* — për të cilin është krijuar kartoteka e leksikut me rreth 1 milion e gjysëm skeda — dhe *Gramatika shkencore e shqipes* — hartimi i së cilës duhet të fillojë vitin e ardh-

hëm, duke pasur në dispozicion një kartotekë me rreth 250.000 skeda; janë në përfundim "Studimet etimologjike të shqipes" prej më se 4000 fjalësh; janë përfunduar 14 fjalorë shumëgjuhësh shqip-rusisht-frengjisht të terminologjive të ndryshme shkencore e teknike me më se 20.000 fjalë; janë futur në një fazë të re kërkimet dialektologjike, faza e parë e të cilëve është në përfundim e sipër.

Mbas seancës së parë plenare sesioni i zhvilloi punimet në dy seksione: të shkencave historike e filologjike.

Androkli Kostallari e deklaroi të hapur seancën e parë të seksionit të gjuhësisë, letërsisë e folklorit. Seanca filloi në 2 nëntor para dite me kumtesën e sh. *Lirak Dodbiba "Leksiku i sotëm detar në shqipet"*, ku vlerësohet natyra e leksikut të sotëm detar në shqipet duke u vënë në dukje shtrirja dhe përbërja e tij në tri pika me rëndësi të bregdetit tonë: Shëngjin-Durrës-Sarandë. Autori provon se në leksikon tonë detar, megjithë numrin e madh të huazimeve, ka edhe mjaft fjalë shqipe, sidomos në punë të detit, të gjeomorfologjisë, të astronomisë dhe të disa pajtimeve të barkës e në manevrat. Sillen argumenta që përligjin mungesën e emrave për disa kategori peshqish që gjohen në det të hapët. Duke iu sjellur folklorit ai provon se deti, si edhe mali e brigjet, del pjesë e pandarë e njëdit ku ka jetuar prej kohëve më të lashta populli ynë. Duke u bazuar në disa huazime të lashta në shtrirjen e tyre e duke marrë konsideratë edhe natyrën e përzjerë për rga origjina të leksikut detar të vendeve të tjera mesdhetare, kumtonjësi bën një përpjekje me sukses për të rrezuar tezën e G. Weigandit e të tjerëve të cilët i mohojnë **epullit** tonë autoktoninë në vendbanimet

sotme në mbështetje kryesisht të përbërjes së leksikut detar, simbas tyre gjoja krejtësisht i huazuar.

Në kumtesën pasonjëse "Hyrja e turqizimeve në gjuhën shqipe dhe përpjekjet për zëvendësimin e tyre" Anton Krajni vuri në dukje se shqipja, në krahasim me gjuhët ballkanike nuk ka në leksikon e saj një volum aq të madh turqizmesh sa mund të mendohet. Turqizmat për ne janë fjalë të marrura nga turqishtja — pavarësisht

nga burimi dhe mënyra e futjes së tyre në shqipet. Ato hynë më tepër me anë të të folurit.

Autori përmendi se nga analiza e shkrimeve t'asaj kohe del se cënimet e leksikut të shqipes nuk janë të rënda edhe në fazën e parë të pushtimit otoman. Këtë ai e shpjegoi me qëllimin e autorëve të teksteve fetare si shërbëtorë të kishës për të qenë sa më të kuptueshëm prej popullit.

Shkrimet e para të gjuhës sonë pasqyrojnë në leksikon e asokohëshëm të shqipes kryesisht fshatare, ku sundimi turk ende s'ishte ngulitur. Duke bërë një statistikë të turqizimeve të autorët e vjetër ai nxori në pah rritmin e përhapjes së turqizimeve në dy shekujt e parë si edhe në dy shekujt e mëpastajmë të sundimit turk. Në rastin e fundit krahas hyrjes së turqizimeve me anë të të folurit kemi dhe hyrjen e tyre me anë të shkollave dhe mejepeve të hapura në vendin tonë. Por këto, duke qenë të pakta në numur e të pafrekuentuara prej të gjithëve, ndihmuan pak. Autori vuri më në fund në dukje përpjekjet me sukses të Rilindasve për pastrimin e shqipes nga fjalët turke, vazhdimin e kësaj pune deri sot dhe detyrat që i dalin leksikologjisë në këtë drejtim.

Shoku *Pashko Geci* në kumtesën e vet "Frang Bardhi dhe fjalori i tij latin-shqip" u përpoq të tregojë me shembuj ku është bazuar Bardhi për mbledhjen e glosarit dhe deri ku u përgjigjen ekuivalentet shqipe lemave latine. Po me anë shembujsh kumtonjësi u mundua të vërtetonte se në kohën e Bardhit një pjesë e mirë e mbiemrave që sot janë të nryshëm atëhere janë përdorur pa nryjë dhe mbiemri cilësor në shumë raste është vendosur para emrit.

Serinë e kumtesave për seancën e paradites e mbylli "Për ndikesat gjuhësore të Bogdanit" e sh. *Kolë Ashta*. Autori bëri përpjekje të vinte në dukje e të shpjegonte elementet e ndryshëm që ka konstatuar në gjuhën e veprës së Bogdanit (shek. XVIII): elemente të gegërishtes lindore që vijnë nga origjina e Bogdanit prej Gurit të Hasit në Kosovë; veçori të gegërishtes veriperëndimore që i shpjegoi me ndënjien e Bogdanit në Shkodër dhe me tra-

ditat e një gjuhe letrare pak a shumë të formuar. Ai ka konstatuar ndikesa të tekstit shqip mbi versionin italisht e të italishtes mbi tekstin shqip që i shpjegoi me përkthimin ad litteram të citateve italisht e latinisht brenda tekstit shqip, ose me nevojën për përputhjen e të dy teksteve.

Seanca u mbyll me diskutimet e shokëve: A. Krajinë rreth kumtesës së Lirak Dodbibës T. Dizdari e A. Kostallari rreth kumtesës së Krajinë dhe S. Riza rreth kumtesës së Kolë Ashtës.

Në seancën e mbasditës që u hap n'ora 16⁰⁰ Jani Thomaj me kumtesën "Mbi shpërndarjen e gjymtyrëve të frazeologjizmeve të shqipes në fjalë" shtroi problemin e marrëdhënies në mes veçorisë semantike dhe asaj gramatikore të frazeologjizmeve të shqipes. Ai arriti në përfundimin se tipari esencial i frazeologjizmeve gjuhësore është uniteti semantik, por jo i pakushtëzuar, përkundrazi, i kushtëzuar nga funksioni gramatikor i togfjalëshit. Shpërndarja e gjymtyrëve të këtij brenda një fjalisë — tha më në fund kumtonjësi — nuk sjell çpërbërjen e frazeologjizmit semantikisht, ndërsa shpërndarja e tyre në fjalë të ndryshme sjell çpërbërjen e frazeologjizmit edhe semantikisht.

Në kumtesën "Rreth disa çfaqjeve të ndikimit të homonimeve në gjuhën shqipe" Xhevat Lloshi dha raste kur homonimia ka ndikuar në zhvillimin e leksikut të gjuhës shqipe në disa drejtime, synoi të tregonte arsëyet përse ky ndikim është i kufizuar në gjuhë dhe nxori që këtej specifikën e homonimisë si një fenomen që është pasojë e veprimit të ligjeve dhe rregullave të tjera të gjuhës.

Miço Samara në kumtesën "Antonimia në fjalët shqipe me parashtesa" pasi bëri një përmbledhje të rezultateve të arritura në studimin e antonimisë, miratoi mendimin se marrëdhënie antonimike vihen re jo vetëm midis fjalëve me rrënjë të ndryshme, por edhe midis fjalëve me parashtesa me funksion antonimik. Ai bëri klasifikimin semantik e strukturor të fjalëve-antonimeve, me parashtesa në gjuhën shqipe, duke e lidhur këtë klasifikim edhe me pasqyrimin e tyre në fjalorët e shqipes.

Me kumtesën "Çështje të sinonimisë në gjuhën shqipe" Palok Daka bëri përpjekje

për të përmbledhur rezultatet e arritura në studimin e sinonimisë shqipe dhe u përqëndrua në problemin e përkufizimit të sinonimisë. Kumtonjësi i bëri një vështrim kritik pasqyrimin të sinonimeve në fjalorin e gjuhës shqipe (1954). Në fund dha një provë të klasifikimit të sinonimeve në shqipet.

Më në fund, *Ferdinand Leka* në kumtesën "Disa marrëdhënie midis fjalës dhe termit u muar me marrëdhëniet që ka fjala e zakonëshme me termën (fjalën speciale) në shqipet duke bërë krahasime edhe me gjuhët e tjera. Ai u kushtoi vëmendje më tepër futjes së fjalës speciale në gjuhë. Kjo gjë i dha rast atij që të polemizonte me ata që nuk kujdesen sa duhet për shqipërimin e terminologjisë. Ai theksoi se përdorimi pa kriter i termave të huaja e varfëron mbarë gjuhën dhe jo vetëm një lëm special të terminologjisë, mbasi termi mban lidhje të vazhdueshme me fjalën e zakonëshme.

Rreth kumtesave të lexuara në seancën e dytë diskutuan shokët: S. Riza, Xh. Lloshi, A. Kostallari, E. Lafa dhe M. Qirici.

Seanca e III u hap me kumtesën e Qemal. Hazhihasanit "Disa probleme lidhur me lindjen dhe zhvillimin e folklorit të luftës N. Çl." Në këtë kumtesë autori analizoi brendinë dhe frymën revolucionare të këngëve të luftës N. Çl., të cilat vunë themelet e një drejtimi të ri në mendimin poetik popullor, hapën rrugë të re në zhvillimin e mëtejshëm të folklorit, duke mos lënë aspak mënjanë traditat më të mira folkloristike të popullit tonë, përkundrazi, duke i vazhduar ato, por duke u dhënë një përmbajtje të re.

Sh. Nexhat Agolli mbajti kumtesën "Disa rezultate nga ekspedita koreografike në lokalitetin e Zalldardhës" ku shqyrto në mënyrë të përgjithëshme vallet e burrave dhe të grave, vallet e "rënda" dhe të "lehta" të burrave, bëri një analizë të strukturës, plastikës, ritmikës, formacioneve të valleve dhe përputhjes së lëvizjeve me frazat muzikore. Kumtonjësi foli edhe për rolin e individit në krijimin e valleve popullore. Problemi i pasurimit, përtëritjes dhe krijimit të valleve popullore — vijoi ai — është një fenomen i dukshëm që hedh poshtë mendimin borgjez

se gjoja folklori s'është gje tjetër veçse jehonë, krijim i së kaluarës. Ai arriti në përfundim se gjithë krijimi artistik i vllëve të Zalldardhës është pjesë vijuese e përbërëse e unitetit kombëtar koreografik të krijuar e të trashëguar brez pas brezi.

Në kumtesën e vet *Dhimitër Pilika* solli të dhëna "Rreth një dorëshkrimi tjetër të Th. Mitkos (v. 1889) të panjohur tek ne". Ai u përpoq të bëjë një lidhje midis vomeve të sotme dhe atyre të moçmeve, bëri aluzion për pasqyrimin e të vjetrave në të reja; për një kryefill trako-ilir dhe dha disa mendime mbi elegjinë shqiptare.

Një kontribut të ri në njohjen e poetit arbëresh Vinçenc Stratigoi solli *Ziaudin Kodra* me kumtesën "Vinçenc Stratigoi (të dhëna të reja rreth veprës së tij)". Autori solli të dhëna të reja mbi këtë poet demokrat arbëresh të gjysmës së dytë të shekullit të kaluar, e vuri në dukje disa objekte të rëndësishme të figurës së tij. Duke sjellë pasazhe të tërë nga veprimtaria letrare e publicistika e poetit ai nxori para opinionit shkencor një figurë të ndritur, një poet të lirisë me dashuri të flaktë për atdheun e largët të stërgjyshërve dhe me tendencë socialiste.

Një problemi të ndërlikuar të letërsisë i kushtohej kumtesa e sh. *Luan Kokona* "Cilës rrymë letrare i përket vepra e Migjenit?" ku u bë përpjekja për ta parë krijimtarinë e këtij poeti në dritën e rrethanave historiko-shoqërore të kohës. Autori i nxori konkluzionet e veta nga analiza e karakteristikave kryesore të poezisë e të prozës së Migjenit, të vështruara në sfondin e letërsisë së asaj kohe. Ai arriti në përfundimin se në vitet '30 s'mund të flitet për realizëm socialist dhe se vepra e Migjenit në përgjithësi e në thelb i përket realizmit kritik revolucionar e një pjesë e vogël romantizmit revolucionar.

Në kumtesën e fundit për seancën e mëngjezit "Vëzhgime mbi disa motive të Goethes te poezitë e Hilë Mosit" *Niko Vangjeli* trajtoi në planin e letërsisë krahasuese një pjesë të krijimtarisë poetike të H. Mosit, ndikimin e këtij në krijimtarinë e vet nga poezia e poetit të madh gjerman J. W. Goethe.

Lidhur me këto kumtesa diskutuan: Z. Sako për kumtesën e Dh. Pilikës e N.

Agollit, A. Krajni për kumtesën e Dh. Pilikës, A. Kostallari për kumtesat e Z. Kodrës e N. Vangjelit dhe K. Bihiku për kumtesat e L. Kokonës e N. Vangjelit.

Në seancën e IV *Spiro Floqi* mbajti kumtesën "Tipe semantiko-strukturore të përdhës me fjali të varur pa lidhje korelative". Kumtonjësi parashtroi një klasifikim të ri të periudhave me fjali të varur në bazë unike, njëherazi kuptimore e strukturore. Ai vuri në dukje shtrirjen e gjërë të lidhjes jokorelative në shqipen e sotme si dhe përdorimin e diferencuar të mjeteve të ndryshme të lidhjes sipas sferave stilistiko-gjinore të përdorimit të tyre dhe pasurimin e vazhdueshëm të këtyre mjeteve me lidhëza të reja.

Stefan Prifti në kumtesën "Elipsa në sintaksën shqipe", mbasi shqyrtoi pikëpamjet e ndryshme lidhur me kategoritë logjike e gramatikore, e cilësoi elipsën si një fenomen të formës lidhur me brendinë që ajo shpreh. Ai u ngrit kundër atyre që i venë elipsës një bazë më fort psikologjike se sa gjuhësore. Kuptimi i drejtë i elipsës — tha ai — del në dritë nga mbështetja në raportet themelore të gjuhës me mendimin, në uitetin e tyre dialektik, në pohimin se gjuha është veshja materiale e mendimit. Ai vuri si kusht të elipsës mungesën e korespondencës së plotë ndërmjet elementëve që ndërtojnë formën e jashtme të shprehjes gramatikore të mendimit dhe elementeve që ndërtojnë formën e brendëshme të ndërtimit të tij. Por kjo s'do të thotë identifikim të tyre — nënvizoi kumtonjësi. Pastaj autori dha rastet e veçanta të elipsës në shqipet dhe rezultatet e saj në sintaksë të ilustruara me material gjuhësor.

Në kumtesën "Një vështrim mbi foljet me më se një reksion në shqipen e sotme letrare" *Ali Dhrimo* bëri një grupëzim të foljeve simbas reksionit të tyre, u muar me drejtimin e lëvizjes së reksionit foljor në shqipet dhe u përpoq të përcaktonte shkaqet e kësaj lëvizjeje.

Kumtesa e fundit për këtë seancë ishte "Trajatat e urdhërores te Gjon Buzuku" ku *Emil Lafa*, duke u mbështetur në vjelljen e plotë të trajtave gramatikore e të leksikut të Gjon Buzukut, foli për trajtat

e ndryshme të urdhërores të ky autor, duke i shoqëruar vërejtjet e tij me të dhëna statistikore të sakta dhe dha mendime për formimin historik të këtyre trajtave.

Mbi kumtesat e dëgjua u diskutua prej: *M. Domit, S. Rizës A. Kostallarit e S. Floqit.*

Në seancën e pestë Prof. *Eqrem Çabej* në kumtesën "*Struktura dialektore e shqipes në zhvillimin historik të saj*" vuri në dukje se në historinë e dy dialekteve kryesore të shqipes e në kronologjinë e tipareve që i dallojnë nga njëri-tjetri duhet të bëhet një shtresim i këtyre: në fillim të periodes letrare, e cila përqendrohet përgjithësisht me përshtimin e vendit prej osmanëve, këta dy dialekte kanë qënë më afër njëri-tjetrit se sot, sikundër tregon ndër të tjera një krahasim i gjuhës së Gjon Buzukut me atë të Lekë Matrëngës prej Shqipërisë. Gjatë kësaj periode vihen re disa inovacione që kanë dalë më fort në anë të gegërishtes e që sollën një largim të dialekteve nga njëri-tjetri. Në periudhën mesjetare — paraletrare përkundrazi, gegërishtja paraqitet më konservative, toskërishtja kryen më fort inovacione. Për këtë periudhë vihen re disa diferencime përbrenda gegërishtes, të cilat janë mjaft të lashta, pjesërisht mbase më të lashta se dallimet që veçojnë gegërishten nga toskërishtja. Mjetet e kërkimit në këtë fushë studimesh — përfundoi ai — janë dialektet e ndryshëm brenda dhe jashtë Shqipërisë, monumentet e vjetra letrarë, onomastika historike dhe mënëfund marrëdhëniet e shqipes me gjuhët fqinje.

Jorgji Gjinar mbajti kumtesën "*Konkordanca të toskërishtes veriore me gegërishten jugore*" ku përmendi raporte dhe marrëdhënie të dialekteve të shqipes, duke i parë ato kryesisht në dy nëndialektet e lartpërmendura. Mbase vuri në dukje marrëdhëniet dhe kontaktet e banorëve të këtyre zonave gjatë zhvillimit historik, ai parashtroi konkordancat në sferat e fonetikës, morfologjisë dhe sintaksës. Kumtonjësi përfundoi duke treguar nevojën e studimit të këtyre çështjeve: ndikimet gjuhësore në njerëz apo tjetër anë të Shkumbinit, ruajtjen e tipareve dikur të përbashkët, zhvillimet e pavarur paralele dhe kronologjinë e fenomeneve. Një kum-

tesë me karakter dialektor e dialektohistorik mbajti edhe *Bahri Beci*. Duke folur "*Rreth historisë së tingullit y në gjuhën shqipe*" kumtonjësi, në kundërshtim me dijen e deritashme, bëri përpjekje të argumentonte tezën e vet se kalimi i *ū* indoevropiane ose latine në *y* është bërë në mënyrë të pandërmjetëshme dhe i përket një periudhe të lashtë të shqipes. Pastaj u përcaktuan prej tij në vijat kryesore izoglosat e varianteve *i, ai; a'i, ei, ëi, o* dhe *φ* të *y-së* në të folmet e Gegërisë së Mesme në veçanti. Më në fund autori u mundua të mbronte tezën se kalimi i *y-së* në *i* në të folmet e pjesës lindore të Gegërisë së Mesme është bërë nën ndikimin e maqedonishtes në periudhën përpara fundit të shek. XIV.

Duke kumtuar mbi "*Trajtat e pjesores të foljeve me temë më likuide në toskërishten e folur dhe të shkruar*" *Menella Totoni* bëri një trajtim në planin aktual dhe historik të problemit. Mbase sqaroi gjërat aktuale nëpër të folmet e ndryshme të toskërishtes e në toskërishten e shkruar, kumtonjësi, duke mbështetur tezën e G. Meyerit — simbas së cilës formanti *-ë* është rezultat i asimilimit të *n-së* së formantit në me likuidën e temës, — përdorimin e formanteve *-ur* dhe *-tur* e pa si një shtrirje analogjike. Ai arriti në përfundimin se prirja drejt përgjithësimin të mbaresës-*ur* në gjithë foljet më likuide është më e theksuar në toskërishten e shkruar se në të folurën.

Serinë e kumtesave të lexuara në këtë sesion shkencor e mbylli kumtesa "*Mbi dallimet kuantitative të zanoreve të theksueme në shqipet*" e sh. *Mehmet Çeliku*, ku, mbase jepen format kryesore të fjalëve që përbëjnë problem dialektor lidhur me shkallët fonetike të kuantitetit të zanoreve të theksuara, arrihet në këto konkluzione kryesore:

1) Interes dialektor në gjuhën e sotme shqipe paraqesin jo vetëm zanoret e gjata, por edhe ato të gjatësisë së mesme.

2) Jo vetëm në toskërishten, por edhe në gegërishten po vihen re tendenca drejt rrafshimit të shkallëve të gjatësisë e të gjatësisë së mesme.

Në diskutimet e fundit e morën fjalën shokët: *M. Domi, S. Riza e A. Krajni* rreth kumtesës së Prof. E. Çabejt, *M.*

Çeliku, B. Beci e P. Gjijnuri mbi kumtesën e J. Gjinarit, E. Çabej, J. Gjinarit, e M. Domi për kumtesën e B. Becit dhe Z. Sako e A. Dodi rreth kumtesës së M. Çelikut.

* * *

Më datën 5 nëntor, mbasi u dëgjuan konkluzionet e sesionit shkencor të bëra për seksionin historik nga kandidati i shkencave historike sh. *Ligor Mile* dhe për sek-

sionin filologjik nga kandidati i shkencave filologjike Prof. *Mahir Domi*, sh. *Androkli Kostallari*, drejtor i Institutit të Historisë dhe të Gjuhësisë e deklaroi të mbyllur sesionin shkencor, duke uruar dhe falënderuar gjithë pjesëmarrësit.

Materjalet e seksionit të shkencave filologjike do të botohen në numrat e ardhshëm të revistës tonë.

A. Dh.

MBRËMJE PËRKUJTIMORE DHE SESION SHKENCOR ME RASTIN E 150-VJETORIT TË LINDJES SË JEROMIN DE RADËS

Me rastin e 150-vjetorit të lindjes së poetit dhe patriotit të madh arbëresh Jeronim De Rada, Komisioni Kombëtar i ngritur për këtë qëllim organizoi më 4 dhjetor në sallën kryesore të Universitetit Shtetëror të Tiranës një mbrëmje përkujtimore. Në mbrëmje asistente anëtarë i Byrosë Politike dhe Sekretari i Komitetit Qëndrorë të Partisë së Punës së Shqipërisë Ramiz Alia, anëtar i Komitetit Qëndror të P. P.SH. Fadil Paqrami, Rektori i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Kahreman Ylli, Zv. Ministria e Arësimit dhe Kulturës Qibrice Ciu, drejtori i Institutit të Historisë dhe të Gjuhësisë pranë Universitetit Shtetëror të Tiranës Androkli Kostallari, drejtori i Institutit të Folklorit Zihni Sako etj. Merrnin pjesë në mbrëmje gjithashtu pedagogë të Fakultetit Histori-Filologji, punonjës shkencorë të Institutit të Historisë dhe të Gjuhësisë, shkrimtarë, punonjës të letërsisë etj.

Mbrëmjen e hapi Rektori i Universitetit Shtetëror të Tiranës Kahreman Ylli.

Pastaj e mori fjalën kryetari i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë Prof. Dhimitër S. Shuteriqi, i cili foli rreth veprimtarisë letrare dhe patriotike të arbëreshit të madh. Pas fjalës së Prof. Shuteriqit poetët Andrea Varfi dhe Llazari Siliqi recituan pjesë nga veprat e De Radës, përshtatur në gjuhën e sotme shqipe.

Në referatin e tij, Prof. Shuteriqi theksoi se De Rada e nisi rrugën letrare në një kohë, kur në letërsinë botërore ishin çfaqur përfaqësues viganë të një vale të re në letërsi, të tillë si Bajron, Hygo, etj. Njohja me krijimet e bashkëkohësve të

mëdhej, si dhe me letërsinë antike dhe të Rilindjes europiane, i dha mundësi poetit tonë të ngrihet në një lartësi artistike dhe ideore që s'ishte parë gjer atëhere në letërsinë shqipe. Kontaktet me idetë milituese të romantikëve përparimtarë europianë, ngjarjet politike në Itali, sidomos në atë jugore, ku jetonte De Rada, studimi dhe gjurmimi i traditave të lavdishme luftarake të popullit shqiptar, — të gjitha këto përcaktuan karakterin patriotik të veprës së poetit arbëresh, i cili që në çaput e para i caktoi vetes një mision të lartë e fisnik, — propagandimin e ides së madhe të çlirimit t'atdheut nga robëria turke. Më tej referuesi, duke analizuar krijimet e De Radës, vuri në dukje se ideja e çlirimit Kombëtar përshkon tejendatë tërë veprën e begatë të poetit, që nga "Milo-sao" (1836), gjer te "Pasqyrë e një jete njerëzore" (1897). Duke bërë fjalë për rrethanat historike, kur zuri fill veprimtaria politike e De Radës, Prof. Shuteriqi paraqiti një kuadër tërësor të asaj lëvizje çlirimtare, që kishte përfshirë gjithë kontinentin, veçanërisht Italinë dhe Ballkanin.

Vala e Rizorxhimentos italiane rrëmbeu edhe arbëreshët, që ishin prej shekujsh të etur për liri dhe drejtësi. Ndërkaq arbëreshët nuk harronin për asnjë çast se matanë detit ata kishin një atdhe tjetër; adheun stërgjyshor. Ideja e krijimit të një shteti të pavarur shqiptar ka filluar të bëjë gjithnjë e më tepër për vete mendjet e shqiptarëve brenda dhe jashtë vendit. Përpjekjet shumëvjeçare të Ali Pashë Tepelenës në jugë dhe Bushatllivje në veri;

për t'u shkëputur nga vartësia e sulltanit, ca më tepër, qeverisja e pavarur e principatave të tyre për dhjetra vjet pati jehonë të bujshme në Europë, dhe u pa kështu mundësia e plotë e themelimit të një shteti të lirë shqiptar. Korentet e rinj politikë, që po tronditnin Europën, shtronin edhe para patriotëve arbëreshë detyra të reja, më përparimtare nga ç'mund të kryheshin brënda suazës së një lëvizje çlirimtare feudale. Me një material të pasur dokumentar, Prof. Shuteriqi përshkroi veprimtarinë e gjatë e frutdhënëse të De Radës në shumë fusha: letërsi artistike, gjuhësi, folklorikë, publicistikë, dhe para së gjithash veprimtarinë e tij patriotike. Pastaj referuesi u ndal në disa veçanti të artit deradjan. Duke folur për shkaqet, që e bënë veprën e De Radës të njihet pak aso kohe në Shqipëri, ndër të tjera prof. Shuteriqi nënvizoi faktin se gjuha e poetit është vështirë të kuptohet nga lexuesi i gjerë, meqë ajo mbështetet kryesisht mbi të folmen arkaikë të arbëreshëve të Kalabrisë. Vështirësitë e botimeve dhe përhapjes së librave, pengesat që krijonin forcat reaksionare brenda dhe jashtë Shqipërisë, kanë ndikuar gjithashtu negativisht në përhapjen e shkrimeve të De Radës në atdheun e tij. Së fundi referuesi ceku problemin, tashmë të njohur, të ndikimit veçanërisht të thellë, që ka ushtruar vepra e poetit të madh të Rilindjes tonë Kombëtare, Jeronim De Rada, në letërsinë arbëreshe. Ndikime të De Radës referuesi sheh edhe në letërsinë shqipe në Shqipëri, por këtë ai e konsideron një çështje, që lyp kërkime dhe studime të mëtejshëm më të thelluar. Duke mbaruar fjalën e tij, referuesi nënvizoi se vetëm pas çlirimit të Shqipërisë me kujdesin e Partisë tonë të Punës vepra e De Radës u bë objekt studimesh e botimesh serioze në Shqipëri, dhe emri i nderuar i poetit arbëresh zuri vendin e merituar në radhën e bijve më të çqar të popullit shqiptar.

Një ditë më vonë (5 dhjetor) për nder të 150. vjetorit të lindjes së De Radës u zhvillua një sesion shkencor. Në sesion u lexuan shtatë kumtesa nga punonjës shkencorë të Institutit të Historisë dhe të Gjuhësisë dhe studimtarë të tjerë.

Sesionin e deklaroi të hapur *Androkli Kostallari*, drejtor i Institutit të Historisë dhe të Gjuhësisë. Pastaj e mori fjalën *Zihni Sako*, drejtor i Institutit të Folklorit, i cili lexoi kumtesën "*Jeronim De Rada dhe veprimtaria e tij në fushën e kërkimeve dhe botimeve folklorike*". Kumtuesi vuri në dukje se Jeronim De Rada edhe si folklorist zë një vënd të çqar në historinë e kulturës shqiptare. Kërkimet shumëvjeçare të poetit në fushën e folklorikës shqiptare, botimet në këtë fashë, që u kryen prej tij, kanë lojtur një rol të rëndësishëm në njohjen dhe studimin e thesareve shpirtërorë të popullit shqiptar, në zgjimin dhe formimin e ndergjegjes tonë kombëtare në mesin e shekullit të kaluar. Në kumtesë bëhet përpjekje për ta rrokur veprimtarinë folklorike të De Radës në një plan të gjërë, si shprehje konkrete të atij hovi të vullshëm që mori në Europë studimi i traditave kulturore të popullit në epokën e romantizmit dhe në një periudhë të re të historisë së Shqipërisë, kur nevoja e bashkimit kombëtar kërkonte veç të tjerash edhe zbulimin e evidencimin e elementëve të përbashkët kulturorë të krahinave të ndryshme të vendit. Një varg dijetarësh europianë fillojnë t'i kthejnë sytë nga e kaluara e popujve. Këtë rrugë e çeli Xh. Makferson i pasuar nga vëllezërit Grim, e të tjerë. Në vazhdim e tyre eci edhe De Rada ynë, duke u bërë kështu prekursor i Mitkos dhe Dines. Lidhur me parimet estetike të De Radës në mbledhjen dhe botimin e folklorit, kumtuesi verën se ashtu ai, thuajse, të gjithë romantikët, edhe poeti arbëresh, rëndom, shtratit popullor të balladës a rapsodisë i bënë një tërhapje mjeshtërore për t'i dhënë në këtë mënyrë krijimit popullor më tepër dinjitet artistik, por pa cënauar boshtin themelor.

Kandidati i shkencave filologjike; docent *Ziaudin Kodra* paraqiti në sesion kumtesën "*Jeronim De Rada krijonjës i letërsisë artistike shqipe me frymë kombëtare dhe ndikimi i tij tek shkrimtarët arbëreshë*". (Për përmbajtjen shih tekstin e plotë të kumtesës, botuar po në këtë numur të revistës.)

Është e ditur se sado i talentuar prej natyre të ish De Rada, sado e pasur të ish poezia jonë popullore, prej së cilës

poeti mori brumin e poezisë së vet, pa një traditë në letërsinë shqipe të shkruar, ai nuk mund të ngrihej në atë lartësi të artit poetik, nëse nuk do të qe i paisur me një kulturë të begatë letrare, me një horizont të gjerë poetik, nëse nuk do të njihje thesaret e letërsisë botërore. Është gjithashtu e ditur se De Rada, sikundër gjithë poetët e botës, ka ndjerë në krijimet e veta ndikimin e paraardhësve të tij, poetëve që ka pas më për zemër. Hetimi i këtij fenomeni përbën një problem me rëndësi për vlerësimin e plotë përgjithësues të veprës së De Radës, dhe ka tërhequr prej kohësh vëmendjen e studiuarëve. Por konstatimet e gjertanishëm mbartin, përgjithësisht, karakter të njëanshëm, ata s'kanë qenë sa duhet të thelluar. Është folur, bie fjala, me vend e pa vend, për ndikime të dukshëm të poezisë italiane në veprat e De Radës. Gualtieri e disa të tjerë "gjejnë" gjithëkund në "Milosao" e gjetiu, "ndikime", bile, "vargje" të Leopardit e të poetëve të tjerë italianë, teksa dibet mirë se poezia e freskët, e gjallë e shëndetshme e poetit tonë s'mund të ketë asgjë të përbashkët me frymën depresive të poezisë së Leopardit. Është fol pak, ose aspak, rreth ndikimeve të mundshëm të poezisë së lashtë klasike europiane dhe lindore, ndërsa intuïta e mprehtë artistike e Lamartinit më shumë se një shekull më parë, qysh në njohjen e parë me veprën e parë të poetit arbëresh, pikasi origjinalitetin dhe freskinë e artit deradjan, të cilit s'i gjendej shembulltëri në artin europian të kohës.

Këtij problemi i kushtohet kumtesa, që u lexua në sesionin nga Prof. *Eqrem Çabej* "Mbi disa karaktere të poezisë së De Radës". Pasi nënvizon një nga veçoritë kryesore të poezisë deradjanë, karakterin e saj popullor, çka shprehet në frymën e poezisë, figuracionin, metrikën, në zgjedhjen e lëndës e të herojve, Prof. Çabej kalon në kostatimin e burimeve letrare indianë për disa motive e elemente të veprës së De Radës. Kështu, te motivi i kqyrjes së një pikturë që paraqet Anmaria Kominiatën, nga ana e së motrës Delia dhe së bijës Adine te "Nata e Kërshëndellave", Prof. Çabej gjen diçka analoge me një skenë të dramës "Sakuntala" të Kalidasës. Emrin e Vantisanes të libri i pestë i poemës "Skënder-

beu i pafan" kumtuesi e sheh të prejardhur nga Savantasena, herionë e dramës Mrhakatika të Dandinit, bashkëkohës i Kalidasës. Një tjetër emër indas është Davadasa, e cila del në këngën e gjashtë e të tetë të "Serafina Topisë" të De Radës. Motivi i djegies në furrën e druve, që haset në dramën e Dandinit, përkon me një skenë analoge te përpunimi i dytë i "Serafina Topisë". Prof. Çabej përfundoi duke çfaqur mendimin se me kërkime më të thelluar në të ardhshmen mund të gjenden gjurmë të tjera të letërsisë inde në veprat e De Radës.

Punës më se gjysmëshekullore të De Radës në lëmin e gjuhësisë shqiptare iu kushtua kumtesa "Veprat gjuhësore të Jeronim De Radës" nga pedagogu Jup Kastrati (Shkodër). (Për përmbajtjen shih tekstin e plotë të kumtesës, botuar po në këtë numur të revistës).

Një faqe të shkëlqyer në trashëgiminë e De Radës përbën aktiviteti i tij shoqëror e politik. Këtij aspekti iu kushtua kumtesa e lexuar nga *Andrea Varfi* "Rreth qëndrimit dhe ideve politike shoqërore të De Radës". Që në krye autori bënë konstatimin me interes se personalitetet arbëreshë nuk duhen kqyrr vetëm në raport me problematikën shqiptare, me qëndrimin e tyre ndaj interesave të atdheut të tyre përtej detit, por duhen parë edhe në qëndrimin e tyre ndaj çështjeve themelore që preokuponin atdheun e tyre të dytë, Italinë. Duke i qëndruar konsequent kësaj teze, kumtuesi vëren më tej se kritika e gjertanishme për De Radën, madje edhe kritika e re shqiptare, nuk ka mundur dot t'i bëjë një vlerësim të plotë objektiv aktivitetit politik të poetit, veçanërisht për periudhën pas vjetëve 1848-1849. Më poshtë kumtuesi sjell një varg argumentesh, të cilët dëshmojnë se edhe pas vjetëve të përmëndur më lart, De Rada jo vetëm që nuk hoqi dorë nga jeta politike si çështje pohuar radhazi, por vazhdoi me një forcë të re luftën për realizimin e idealeve të vetë përparimtarë. Opozicionin dhe pastaj luftën e hapur të poetit kundër borgjezisë italiane pas kryengritjes së 1848, autori i kumtesës e shpjegon me faktin se pas vendosjes në Itali të pushtetit koalicionial borgjezo-feudal, borgjezia italiane i tradhëtoi interesat e popullit dhe prem-

timet e saj demagogjike u bënë hi e pluhur. Në ksi kushtesh luftëtarët konseguentë nuk mund ta qvanin të mbaruar luftën e nisur prej tyre, gjersa kërkesat e tyre mbeteshin të porealizuara dhe problemet të pazgjdhur. De Rada u bashkua pikërisht me krahun përparimtar, me ata të cilët nuk u mashtruan nga propaganda çoroditëse e borgjezisë dhe liberalëve. Tanimë përfaqësuesit e vendosur të vegjëlisë (ndër ta edhe De Rada) duhej t'i kthenin (dhe i kthyen) armët kundër aleatëve të tyre të djeshëm, borgjezisë dhe liberalëve. Së këndejmi mund të kuptohet shkaku i vërtetë i reputacionit politik të krijuar rreth figurës së patriotit De Radë prej kundërshtarëve të tij. Kuntuesi citon një numur shkrimesh të poetit, në të cilët janë shprehur pikëpamjet e tij rreth problemeve të mëdha të kohës.

"Rreth ritmit në poezinë e De Radës"
— Kështu titullohej kumtesa e lexuar nga docent *Vehbi Bala* (Shkodër). Kuntuesi kundërshton mendimin e çfaqur nga një varg studimtarësh të huaj e vendës se, gjoja, poezia e De Radës nuk i respekton ligjet e vjershërisë, injoron rregullat e metrikës. Autori i kumtesës mbron të kundërtën, duke sjellë argumenta të mjaftë në përkrahje të parimeve origjinalë të vjershërisë së poetit arbëresh. Vërejtjen e drejtë të bërë nga sa e sa studimtarë për një farë parregullsie të vargjeve të De Radës, kuntuesi e shpjegon me faktin se poezia popullore arbëreshe, mbi të cilën u ngrit poetika e De Radës, mbështetet mbi sistemin prozodik sasior të zanoreve të gjata e të shkurtëra, sikurse ndodhte në metrikën e lashtë klasike. Pra jo mbi sistemin e sotëm silabotonic. Ndoshta, supozon kuntuesi, aty nga sh. XV-XVI u bë kalimi i poezisë gojore nga sistemi ritmik sasior në atë tonik. Në favor të kësaj teze flet edhe grafia e përdorur nga poeti, i cili bën dallimin midis zanoreve të gjata e të shkurtëra, duke i shprehur të gjatat në shkrim me anë të dyfishimit. Edhe më parë L. Benloew (1898), M. Markiano (1902), Z. Sqiroidi i Riu (1959), kanë dalluar në vjershërinë deradiane d'çka, që s'gjasonte me sistemin silabotonic të poezisë moderne. Por arësytimet

për këtë kanë qënë, rëndom, kontradiktorë.

Një ndër problemet më të rëndësishëm e më të ndërlikuar në studimin e krijimtarisë letrare të çdo shkrimtari është përcaktimi i metodës artistike, i parimeve të tij krijues. Në këtë lëm letërsia jonë në të kaluarën s'ka pas kurrëfarë tradite. Vetëm pas çlirimit të vendit, kur studimtarët shqiptarë u armatosën me parimet e materializmit dialektik e historik, u krijuan kushtet për t'i studjuar shkrimtarët tanë të së kaluarës në një plan përgjithësues historik, dhe për tu bërë veprave të tyre një vlerësim më të thelluar nga pozitat e shëndosha të metodologjisë marksiste-leniniste. Në këtë pikë veçanërisht vjetët e fundit po bëhet një punë e mirë. Një interes të posaçëm paraqet studimi i parimeve artistike, prej të cilave janë udhëhequr shkrimtarët tanë të Rilindjes. Ndër ta një vend kryesor zë krijimtaria e poetit të madh Jeronim De Rada.

Pikërisht një problemi të tillë i kushtohet kumtesa e lexuar në sesion nga *Razi Brahim* "Parimet krijonjëse të De Radës".

Kuntuesi gjithë duke u pajtuar me mendimin e përgjithëshëm se vepra e De Radës është kryesisht e një romantiku përparimtar dhe se ajo në tërësi u përgjigjet parimeve estetikë të romantizmit, e konsideron të nevojshme vështrimin e saj në një plan më të gjerë dhe jo ngushtësisht brënda kornizës së parimeve të njohur të romantizmit. Kuntuesi nënvizon se në poezinë e De Radës spikat një shkrirje dhe harmonizim i mahnitshëm i qetësisë klasike, në dukje, me shpirtin e rrëmbyer romantik. Në këtë kuptim — sipas autorit — poezia e De Radës, duke qënë në thelb *poezi-romantike* nuk pajtohet në gjithëka me parimet krijues të romantizmit. Poeti ynë ka krijuar duke asimiluar gjithëka i përshtatej natyrës, koncepteve dhe personalitetit të tij artistik dhe ka mënjanuar gjithëka nuk i përshtatej kërkesave të veta poetike. Kjo është një nga shënjat më të sigurta të një personaliteti të madh artistik, që kërkon dhe gjen rrugën e vet në art, pa ndjekur symbyllur të tjerët. Kuntuesi vëren se në poezinë e De Radës janë shkrirë në një formë mjaft origjinale traditat e poezisë popullore shqiptare, gjurmë të artit antik dhe

elementë të romantizmit të kohës, e në këtë mënyrë romantizmi deradjan ka vullën e vet, që e dallon prej të tjerëve. *Letërsia antike* (harmonia dhe karakteri i përmbajtur i figurës), *letërsia romantike e kohës* (liria e krijimit, figurat e fuqishme me proporcione të mëdha), *krijimtaria popullore* (fryma kombëtare, mjetet shprehës), ja, sipas autorit, cilët janë elementët përbërës të botës poetike të De Radës, një nga parimet krijuese të tij.

Më tej, duke u ndalur në një anë tjetër të krijimtarisë së poetit, kumtuiesi thekson se megjithëse De Rada është kryesisht një poet lirik, veprat e tij kanë, megjithatë, proporcione epikë, çka shprehet në tabllot e gjëra jetësore, në ngjarjet e shumta, që mbushin veprat si "Serafina Topia" dhe "Skëndërbeu i pafan", në fluturimet nga një vend në tjetrin e nga një kohë në tjetren, etj. Në dy veprat e cituara më lart kumtuiesi dallon gjithashtu edhe elementë dramatikë, si nga kuptimi ashtu dhe nga forma e paraqitjes së tyre.

Përsa i përket "fragmentaritetit" të veprave të De Radës, për të cilin poetin e qortojnë shpesh, kumtuiesi mbron pikëpamjen se karakteri fragmentar i poemave të De Radës nuk përbën ndonjë të metë artistike a moskujdesje të autorit ndaj formës dhe kompozicionit, po buron prej parimeve krijuese të poetit. Karakterin fragmentar të "Milosaos" kumtuiesi nuk e quan të një natyre me atë të "Serafina Topisë" dhe "Skëndërbeut të pafan", që i përkasin një periudhe të mëvontë. Në rastin e "Milosaos" "fragmentariteti" kushtëzohet kryesisht nga parimi estetik i De Radës, i cili synon të kapë në krijimin poetik vetëm kulmet, pikat më të larta, duke i dhënë, kështu, lëçitësit

lirinë ta plotësojë vetë tabllon e sapo skicuar nga poeti. Ndërsa në poemat e mëvonta nuk vepron e njejta arësye meqë këtu "fragmentariteti" çfaqet edhe në një aspekt të ri: në shkëputjen kompozicionale të përfytyrimeve poetikë, në kalimin prej një situatë në tjetren, prej një personi në tjetrin, shpesh, në dukje, të palidhur midis tyre. Këtë fenomen në veprën e De Radës kumtuiesi e shpjegon me dëshirën e poetit për të dhënë në reliev një kuadër panoramik të Shqipërisë së atëherëshme, një pasqyrë besnike të jetës shqiptare në një epokë të tërë historike. Pra, sikundër shënon kumtuiesi, interesimet e poetit në ksi rastesh kanë qënë "të pakufizuara dhe të pakushtëzuara, karakteri i reflektimeve poetike krejt tjetër dhe natyra kompozicionale u përshtatet pikërisht atyre synimeve ideo-artistike, që ka patur më parë poeti".

Sëfund i kumtuiesi evidencën edhe një parim tjetër krijues të De Radës, që është dhe një nga karakteristikat më kryesore të veprës së tij: De Rada duke qënë kryesisht poet i mendimeve të thellë, i përgjithësimeve filozofike është në të njëjtën kohë edhe një poet i frymëzuar intim; poeti i detajeve jetësorë, i hoveve shpirtërorë dhe ndjenjave të freskëta njerezore.

Duke e mbyllur sesionin shkencor drejtori i Institutit të Historisë dhe të Gjuhësisë Androkli Kostallari njoftoi se kumtesat e lexuara në sesion, sidhe materialet e tjerë lidhur me aktivitetin e zhvilluar në vendin tonë për ndër të 150-vjetorit të lindjes së Jeronim De Radës, do të botohen së shpejti në një vëllim të veçantë përkujtimor.

I. K

MBLEDHJE KUSHTUAR 150-VJETORIT TË LINDJES SE JERONIM DE RADËS

Dega e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve për rrethin, Këshilli Shkencor i Institutit Pedagogjik dyvjeçar dhe Shtëpia e Kulturës dhe Krijimtarisë popullore të Shkodrës organizuan më 2 dhjetor 1964 një mbrëmje përkujtimore kushtuar 50-vjetorit të lindjes së atdhetarit dhe poetit të madh arbëresh, Jeronim De Rada.

Mbledhjen e deklaroi të hapur Vehbi Bala, kryetar i Degës së Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shkodrës.

Fjalën e rastit e mbajti Jup Kastrati pedagog i Institutit Pedagogjik të Shkodrës. Ai foli mbi jetën dhe veprimtarinë letrare, shoqërore e politike të Jeronim de Radës, Në mënyrë të veçantë referuesi analizo.

krijimtarinë e De Radës, duke u ndalur së pari tek veprat poetike dhe tek veprat folklorike të De Radës. Në fund ai foli mbi punën e madhe që është bërë pas çlirimit për njohjen sa ma të mirë të jetës

dhe të veprimtarisë letrare e patriotike të Jeronim de Radës.

Mbas bisedës u recituan pjesë të zgjedhura nga vepra poetike e De Radës.

J. K.

DISKUTIMI I PARIMEVE TË ZGJEDHJES SË FJALËVE PËR «FJALORIN E GJUHËS SË SOTME SHQIPE»

Sektori i leksikologjisë dhe leksikografisë i Institutit të Historisë dhe të Gjuhësisë organizoi në muajin nëntor diskutimin e parimeve themelore për zgjedhjen e glosarit të fjalorit të ardhshëm të gjuhës shqipe. Në këtë diskutim merrnin pjesë punonjësit e sektorëve të gjuhësisë.

Çështjet themelore, rreth të cilave u zhvillua diskutimi, u paraqitën në punimin "Mbi përbërjen e fjalësit (glosarit) të "Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe", përgatitur nga A. Kostallari. Në këtë punim vihet në dukje se zhvillimi i vullshëm ekonomik, shoqëror dhe kultural i Shqipërisë së re socialiste e bën të domosdoshme hartimin e një fjalori shpjgues, që të përfshijë të gjithë leksikun e gjuhës së sotme letrare shqipe me një përdorim të përgjithshëm. Kësaj detyre sektori i leksikologjisë dhe leksikografisë tashmë mund t'i përvishet për ta zgjidhur në bazë të "Kartotekës së leksikut të shqipes" që u krijua me një punë përgatitore shumëvjeçare. Në rrethin e çështjeve që lindin për hartimin e fjalorit të ardhshëm problemi më i vështirë dhe vendimtar është ai i zgjedhjes së fjalëve. Kjo kërkon që të trajtohen dhe të zgjidhen teorikisht një varg çështjesh themelore e parimore rreth prirjeve të zhvillimit të gjuhës së sotme letrare shqipe, tipareve të saj të sotme dhe detyrave të fjalorit të ardhshëm.

Nga tezat parimore më të rëndësishme të shtruara është teza që, si rezultat i një procesi historik objektiv, ne sot kemi një gjuhë letrare kombëtare me prirje pak a shumë të qarta zhvillimi. Norma e kësaj gjuhe letrare ka disa veçori të caktuara: baza dialektore e saj vepron kryesisht në lëmin e strukturës fonetike; krahas me veçoritë fonetike, në punimin e A. Kostallarit analizohen edhe veçoritë në fushën e morfologjisë e në fushën e fjalëformimit.

Aty theksohet në mënyrë të veçantë roli dhe pasojat e bashkëveprimit ndërdialektor dhe veçoritë e bashkëjetesës së normave-variante.

Fjalori i ardhshëm duhet të jetë një mjet i rëndësishëm për forcimin e unitetit gjuhësor të popullit tonë. Qëllimet kryesore që do të ndjekë ai janë dy: të jetë një fjalor shpjgues normativ dhe të jetë njëkohësisht një fjalor informues. Ai do të bëjë të njohur pasurinë e madhe leksikofrazeologjike të gjuhës së popullit tonë. Parimi udhëheqës më i përgjithshëm për zgjedhjen e fjalëve formulohet kështu: fjalori duhet t'i konsiderojë të gjitha fjalët e fondit leksikor të shqipes së sotme si pasuri e përbashkët kulturele e popullit shqiptar. Vlerësimi i çdo fjale duhet bërë sipas vlerës së saj reale në strukturën leksikore të shqipes së sotme letrare. Veç kësaj parashikohen edhe një sërë kriteresh të veçanta për zgjedhjen e fjalëve. Autori ndalet në trajtimin e rrugëve, nëpërmjet të të cilave duhet të arrihet normativiteti në këtë fjalor të ri, në kuptimin e veçorive të karakterit informues të tij; në problemin e kufijve kohorë të gjuhës së sotme letrare shqipe, në tendencat e zhvillimit të leksikut në gjuhën e sotme etj. "Fjalori i gjuhës së sotme shqipe" do të jetë një fjalor i tipit të mesëm me rreth 55-60.000 fjalë.

Gjatë diskutimit folën të gjithë pjesëmarrësit. Diskutuesit u pajtuan në përgjithësi me parimet themelore të parashtruara. Diskutimi u përqëndrua rreth nocioneve "gjuhë letrare kombëtare" dhe "gjuhë e sotme shqipe", rreth kufijve kohorë të gjuhës së sotme shqipe dhe, rrjedhimisht, kufijve të leksikut që do përfshijë fjalori. U përkrah mendimi që të merren elemente të vlefshme leksikore edhe nga arbëreshët e nga autorët e vjetër.

U rrahën gjërësisht çështjet e bazës dialektore të gjuhës letrare dhe shumica u shprehën se duhet folur vetëm për një mbizotërim të toskërishtes, por jo mbi një bazë eskuzive të toskërishtes; u theksua nevoja e studimit më të thelluar të marrëdhënieve të sotme ndërdialektore. Interes ngjallën çështjet e normës letrare dhe varianteve të saj, vlerësimi i varianteve fonetiko-dialektore të fjalëve, çështja e huazimeve dhe e

pastrimit të gjuhës nga elementet e huaja të panevojshme etj.

Parimet e paraqitura dhe të miratuara nga kolektivi i gjuhëtarëve do të shërbejnë si bazë për zgjedhjen e fjalëve të fjalorit të ardhshëm të gjuhës shqipe, gjë që përbën hapin e parë në këtë punë me vlerë të madhe për kulturën e re socialiste të vendit tonë.

Xh. Ll.